

International
Criminal Tribunal
for the former
Yugoslavia

Tribunal Penal
International pour
l'ex-Yugoslavie

**DEKLARATË NGA PERSONI QË JEP DEKLARATË TË
SHKRUAR NË BAZË TË RREGULLIT 92 BIS**

I,

Emr-i/at dhe mbiemr-i/at: _____

Data dhe Vendi i Lindjes: _____

Nr i dokumentit identifikues ose pasaportës: _____

këtu me këtë konfirmoj, në prani të Zyrtares Kryesues MELINDA TAYLOR

se përmbajtj-a/et e deklarat-ës/ave së/të shkruar/a që unë bëra më 17-20, 21 NOV 99

SHTESA MARRE ME 15/07/02

dhe e/të cila/t tani i është/janë bashkëngjitur kësaj deklaratë, është/janë e/të vërtetë/a dhe e/të saktë/a me sa di dhe me sa besoj.

Më është dhënë gjithashtu një kopje e Rregullit 91 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Tribunalit në një gjuhë që unë e kuptoj dhe kuptoj se mund të ndiqem penalisht për dhënie të dëshmisë së rreme, në qoftë se përmbajtj-a/et e deklarat-ës/ave sime/të mia të shkruar/a nuk është/janë e/të vërtetë/a dhe e/të saktë/a.

Bërë më: 15/07/02

Në: Room 292, ICTY Den Haag

Nënshkrimi i dëshmitarit

Nënshkrimi i Zyrtares Kryesues

Presiding
Officer



Rule 92bis

26

TRIBUNALI NDËRKOMBËTAR PËR NDJEKJEN PENALE TË PERSONAVE
PËRGJEGJËS PËR SHKELJE TË RËNDA TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE
TË KRYERA NË TERRITORIN E ISH-JUGOSLLAVISË QYSH PREJ 1991

DEKLARATA E DËSHMITAR-IT/ES

TË DHËNA MBI DËSHMITAR-IN/EN

Mbiemri: [REDACTED] **K24**
Emri: [REDACTED] Emri i babait: [REDACTED]
Nofka: [REDACTED] Gjinia: **Femër**
Datëlindja: [REDACTED] Vendlindja: [REDACTED]

Përkatësia etnike: **Shqiptare** Feja: **Myslimane**

Gjuhë të folura: **Shqip**
Gjuhë të shkruara (në rast se ka të ndryshme nga të folura)
Gjuhët e përdorura në intervistë: **Shqip-Anglisht**
Profesioni i tanishëm: **Amvisë** I mëparshëm: **Amvisë**
Adresa: [REDACTED]

Data-t e intervist-ës/ave: **17-20; 22 nëntor 1999**

Vendi i intervistës: **Dubovc**

Intervistues: **Dana MATEI**

Përkthyes: **Bora SHPUZA**

Emrat e të gjithë personave të pranishëm gjatë intervistës:

Nënshkrimi/nënshkrim/
(Dëshmitarja)

Inicialet /dy nënshkrime/
(të tjerë të pranishëm)
22 nëntor 1999

[REDACTED]

DEKLARATA E DËSHMITARIT

E kuptoj se më kërkohet të përshkruaj gjërat që unë i di sepse i kam parë dhe do të tregoj qartë në deklaratën time faktet që kam mësuar prej të tjerëve.

Po e jap këtë deklaratë vullnetarisht dhe do të përshkruaj çdo gjë që di me aq sa mundem.

Unë kam kryer katër vite të shkollës fillore dhe katër vite të shkollës së mesme. Jam amvisë. Burri im [REDACTED] [REDACTED]. Ne kemi dy fëmijë; [REDACTED] [REDACTED] dhe [REDACTED] [REDACTED].

Nuk më kujtohet data ose çfarë ditë jave ishte por e di se ishte ora 0600 kur unë isha në shtëpinë e prindërve të mi në Kozhice. Ishte pasi NATO-ja kishte filluar fushatën ajrore në 1999. Në shtëpi ishin; prindërit e mi [REDACTED] 48 vjeç; [REDACTED] 39 vjeç, motra ime [REDACTED], 19 vjeç, vëllezërit e mi [REDACTED], 24 vjeç, [REDACTED], 18 vjeç, [REDACTED], 16 vjeç [REDACTED] 14 vjeç, vjehrra ime [REDACTED] 60 vjeç dhe djali im [REDACTED]. Fshati u rrethua prej shumë ushtarëve të Ushtrisë Jugosllave që erdhën me kamionë të mëdhenj ushtarakë.

Po atë natë, nëna ime, vjehrra ime, vëllai im i vogël, motra ime, djali im, unë dhe gra e fëmijë të tjerë nga lagjia shkuan në një shtëpi lart në kodër sepse menduam se do të ishte më e sigurtë. Gjithsej ishim 22 persona. Shtëpia ishte e kushëririt tim [REDACTED] [REDACTED], 50 vjeç, i cili u largua po atë natë dhe shkoi në mal. Gratë dhe fëmijët nga Kozhica që shkuan në atë shtëpi ishin:

1. Hana HETEMI, 45 vjeç
 2. Rukije HETEMI, 23 vjeç
 3. Gjyla HETEMI, 30 vjeç
 4. Mihrije HETEMI, 36 vjeç
 5. Tahire HETEMI, 19 vjeç
 6. Minire HETEMI, 18 vjeç
 7. Smajl HETEMI, 10 vjeç
 8. Lirim HETEMI, 1 vjeç
- [REDACTED]


9. Miradije DIBRANI, 42 vjeç
10. Merishabe DIBRANI, 27 vjeç
11. Bukurie DIBRANI, 23 vjeç
12. Antigonja DIBRANI, 19 vjeç
13. Bukurie DIBRANI, 25 vjeç
14. Vlora DIBRANI, 12 vjeç
15. Fahrije ADEMI 45 vjeç
16. Lumnie HALIMI 17 vjeç

Babai im dhe vëllezërit e mi shkuan të fshiheshin në mal. Burri im luftonte me UÇK-në në Çiçavicë.

Të nesërmen në mëngjes, pas orës 0700, në atë shtëpi erdhën gjashtë ose shtatë ushtarë të Ushtrisë Jugosllave. Ata kishin veshur uniforma kamuflimi të gjelbër në të verdhë, në mëngë kishin shirita të kuq dhe disa prej tyre kishin kapela kamuflimi me majë të madhe të rrumbullakët. Ata filluan të na bërtitnin. Dhe unë kuptova fjalën serbe që do të thore "shpejt"; ata po na bërtitnin të shkonim shpejt në Qirez. Ata kishin automatikë të mëdhenj. Na kontrolluan dhe na morën të holla, stoli dhe letërnjoftimet. Unë kisha disa çanta të vogla me ushqime dhe me rroba pr të ndërruar foshnjën time, por ata na thanë t'i linim atje. Hoqa nga gishtat tri unaza dhe ua dhashë atyre. Kisha me vete 300 DM dhe stoli të tjera por ato i fsheha në rrobat e mia. Letërnjoftimi im ishte në njërin nga çantat që lashë atje. Ata morën një nga çantat e mia, e kthyen përmbys, buka ra dhe ata filluan t'a shtypnin me këmbë.

Më kujtohet se ata ishin të rinj, te të tridhjetat. E di se ata ishin ushtarë të Ushtrisë Jugosllave sepse më parë ata kishin rrethuar Kozhicën dhe Likoshanin dhe njerëzit rreth e rrotull flisnin mbi këtë. Ne kishim dëgjuar lajmet një muaj më parë në radion BBC dhe në Zërin e Amerikës në shqip që thoshin se fshatrat Kozhicë, Krashaliq, Beçiq dhe Dubovc ishin rrethuar nga forcat e ushtrisë jugosllave, kryesisht Kozhica. Nuk e di sa banorë ishin në Kozhicë por e di që të gjithë ata ishin shqiptarë.

Në atë shtëpi, takova një grua që u paraqit si Mirdita. Ajo ishte 25-26 vjeç, më e gjatë se 1,70m me flokë të gjatë kaçurrelë në ngjyrë kafe, sy të kaltër, pesë muajsh shtatzanë, me buzë të plota dhe dy dhëmbë të përparmë të dëmtuar. Ajo tha se ishte diplomuar në



shkollën mjekësore, por nuk dha hollësi. Mirdita tha se ajo ishte nga Tetova, por unë e dëgjova atë kur u tha grave të tjera se ajo ishte nga Skënderaj ose nga Klina. Ajo ishte vetëm, ajo tha se burri i saj ndodhej në Francë. Mirdita fliste serbisht shumë mirë, sikur të ishte serbe. Tre ushtarë të tjerë të Ushtrisë jugosllave na dërguan të shkonim në Qirez. Këta tre ushtarë të Ushtrisë Jugosllave që nuk kishin qenë më parë midis atyre gjashtë ose shtatë (bënin pjesë në njësinë ushtarake të vendosur në Kozhice) na përcollën.

Diku gjatë rrugës, disa ushtarë të Ushtrisë Jugosllave erdhën me një kamion të vogël dhe na kthyen pas në Kozhice, dhe na çuan në një shtëpi dykatëshe në Kozhice që ishte e Abedin DYRMISHIT, 70 vjeç, i cili në atë kohë ishte në Çiçavicë. Ne ishim më pak se 40 vetë, vetëm gra e fëmijë. Ata i vendosën personat nga Kozhica në një dhomë në katin përdhes. Ata pyetën Mirditën kush ishte nga Kozhica dhe pastaj ajo na tha "Ata thonë se kush është nga Kozhica duhet të zbresë poshtë", dhe ndenji me ne tri ditë e tri netë. Ajo ishte personi që i kontrolloi gratë dhe fëmijët për të holla, stoli dhe letërnjoftime, përpara shumë ushtarëve, kur ne hymë në shtëpi një nga një. Ajo nuk ndenji me ne në të njëjtën dhomë.; mendoj se ajo ndenji në katin e sipërm me ushtarët, por ajo vinte dhe fliste me ne. Ajo përktheu për ne ato që ushtarët e Ushtrisë Jugosllave na kërkuan të bënim. Besoj se Mirdita na spiunonte dhe iu tregonte çdo gjë ushtarëve të Ushtrisë Jugosllave.

Gjithashtu ata i veçuan njerëzit nga Prekazi dhe Klina dhe i çuan në dhoma të ndryshme.

Për tri ditë ne ishim me të vërtetë mirë; ushtarët e Ushtrisë Jugosllave na sillnin ushqime, djath, qumësht, çdo gjë që ata mund të gjenin në shtëpitë e zbrazura të fshatrave. Ata na sollën çaj dhe sheqer. Ishte një furnelë, por ne mund ta përdornim atë vetëm për tu ngrohur por jo për të pjekur bukë, për këtë duhej të shkonim lart. Ushtarët e Ushtrisë Jugosllave na lejonin për këtë por jo çdo herë që ne kërkonim. Te shkallët brenda shtëpisë kishte roje. Pas derës sonë ishte një roje. E shihja atë roje çdo herë që shkoja në banjë. Nuk ishte i njëjti roje gjatë gjithë ditës sepse shumë herë ata ndërroheshin. Edhe oborri ishte plot me ushtarë; këtë ma tha motra ime kur u kthye nga oborri ku ajo kishte larë pelenat e foshnjës. Në çdo kat të shtëpisë kishte ushtarë, më tregoi motra ime sepse ajo shkonte sipër për të gatuar dhe unë i dëgjoja ata kur shtinin gjatë netëve në drejtim të malit të Çiçavicës..



Pastaj pas tri ditësh ata thanë: “ ju të Kozhicës, shkoni në Qirez ! Ju duhet tëshkoni në xhaminë e Qirezit sepse NATO-ja mund t’ju bombardojë dhe t’ju vrasë.” Tre ushtarë thanë diçka në serbisht dhe Mirdita na tha se ata kishin thënë që ne duhej të shkonim në Qirez sepse “ ata kërkojnë që ju të shkoni atje, Ata kërkojnë një grup prej jush.” Ajo nuk dha shpjegime të tjera. Mirdita nuk erdhi me ne në Qirez. Ajo ndenji në atë shtëpi në Kozhicë.

Këta tre ushtarë na përcollën për në Qirez. Ata flisnin vetëm serbisht me ne, por unë nuk i kuptoja çfarë thoshin. Ishim afërsisht 21 vetë nga Kozhica (të njëjtët që kam përmendur më sipër), përveç vjehrrës simë që ishte nga Dubovci. Njerëzit nga fshatrat e tjerë mbetën në atë shtëpi në Kozhicë. Ne ecnim në kolonë. Ushtarët e Ushtrisë jugosllave nuk na çuan në xhami por në shtëpinë e Azem ISLAMIT, 70 vjeç, i cili nuk ishte në shtëpi. Më vonë dëgjova se ai u vra nga serbët bashkë me dy nga djemtë e tij.

Pastaj ata na çuan në një lloj bodrumi me sanë dhe me vende për të ndenjtur lopët. Këta tre ushtarët që na kishin përcjellë nga fshati Kozhicë për në Qirez na lanë me disa burra me shenjën e tigrin në krahë.

Kur hymë në shtëpi, këta tre ushtarët që na shoqëruan, biseduan diçka me tre burrat me shenjën e tigrin në mëngë dhe na lanë me ata. Ata kishin veshur uniforma kamuflimi me një përzierje të së gjelbrës së mbyllët me të verdhë dhe me njolla të kuqe aty-këtu. Ata kishin çizme të mëdha ushtarake. Gjithashtu ata kishin edhe automatikë dhe dy prej tyre kishin nga një thikë të madhe.

Këta tre burra filluan të na mallkonin dhe të na shanin. “Pra ju doni republikë, doni pavarësi!” e kështu me radhë

Në bodrum burrat me shenjën e tigrin dhe me automatikë të drejtuar ndaj grave kërkuan përsëri të holla, stoli dhe letërnjoftimet.

Njëri nga ata kishte flokë biond, të prerë shkurt, pothuajse i rruar, me sy të zinj, lëkurë të bardhë, me trup shumë të madh dhe më dhëmbë të mëdhenj, Ndonjëherë ai vinte në dhomë me maskë, ndonjëherë pa maskë. Ai kishte një puçërr të madhe në qafë, prapa



veshit. Ai ishte në fillim të tridhjetave dhe ishte shumë i gjatë, mendoj pothuajse dy metra.

I dyti ishte i shkurtër, rreth 1, 75 m, me trup të zhvilluar mirë, ai kishte lëkurë të zeshkët dhe mendoj se ai ishte jevg. Ai kishte një kapuç të zi prej leshi në kokë. Ky na ruante më të shumtën e kohës, Unë e kisha parë atë nga vrima e çelësit.

I treti ishte pak më i shkurtër dhe më i hollë se i pari, me lëkurë të zeshkët, flokë të zinj, një gropëz të thellë në mjekër, qerpikë të zinj të dendur dhe sy të zinj. Ky e drejtonte më shumë pushkën nga ne kur na kërkonin të holla dhe stoli.

Kushërira ime [REDACTED], 16 vjeç ishte atje më nënën e saj, [REDACTED], 36 vjeç kur burri me puçrren e madhe pranë veshit po kontrollonte nënën e saj duke e prekur nëpër gjithë trupin, duke përfshirë edhe gjinjtë dhe vaginën, duke kërkuar për sende të çmuara që mund të ishin fshehur. [REDACTED] ishte e frikësuar, kështu që ajo klithi dhe ai e goditi atë me shkelm me çizmet e tij të mëdha dhe e përplasi pas murit kaq fort sa që unë mendova se e vrau. Ajo ka ende probleme tani; dhimbje në gjinj, humbje oreksi dhe anemi. Ai e nxori nënën e saj jashtë dhe kur [REDACTED] u kthye ajo na tha se ai e kishte detyruar atë të dilte në oborr dhe të zhvishej. Ata e kontrolluan atë lakuriq dhe e pyetën për burrin e saj.

I njëjti person erdhi shumë herë në dhomë dhe na kërcënonte me thikën e tij të madhe duke na thënë: "Do t'ju therrim, do t'ju pjekim". Ai tjetri me gropëz në mjekër thoshte: "Jo, në fillim do t'i pjekim, pastaj do t'i presim". Nuk iu besova atyre sepse para asaj dite kishte pasur shumë provokime dhe asgjë nuk kishte ndodhur.

Kur hymë në shtëpi unë kisha 300 DM për lindjen e fëmijës. I dhashë trupmadhit 200 DM, tri unaza ari, një gjerdan dhe një palë vathë. Të gjithë këto sende të çmuara i kisha fshehur në rrobat e mia. Në kashtë fsheha 100 DM.

Pastaj, ai që ishte shumë i gjatë hyri në dhomë me një maskë të zezë leshi në fytyrë. E njoha nga trupi dhe nga dhëmbët e tij të mëdhenj sepse maska kishte një vrimë për gojën. Ai tregoi me gisht nga pesë vajza duke i marrë një nga një. Ai kishte një

[REDACTED]

automatik të cilin e mbante në njërin dorë ndërsa me tjetrën tregonte nga vajzat. Ai fliste shqip shumë mirë. Pesë vajzat ishin:

1. Antigona DIBRANI, 19 vjeç
2. Zahide XHEMA, 19 vjeç
3. Bukurie DIBRANI, 23 vjeç
4. Mirshabe DIBRANI, 27 vjeç
5. [REDACTED]

Bukurie DIBRANI, Antigona DIBRANI dhe Mirshabe DIBRANI ishin motra.

Kjo zgjati afërsisht dy orë; vajzat dilnin një nga një dhe ktheheshin në bodrum me rroba të çrregullta. Pesë minuta pasi mori vajzën e parë ai u kthye në dhomë vetëm, pa maskë dhe bëri një shenjë me dorë te fyti sikur do ta priste. Ai foli në shqip: "Ja preva fytin Antigonës, tani ajo është e vdekur" [REDACTED] ishte e fundit që ai mori nga dhoma.

Ne besuam se këta tre burra me shenja tigri në mëngët e tyre i keqtrajtuuan dhe i përdhuan vajzat. Unë e [REDACTED] time kur ajo u kthye. "Çfarë të bënë" [REDACTED] nuk mundi të fliste. Zahide XHEMA tha: "na zhveshën lakuriq siç na ka bërë nëna." Ajo po dridhej sytë i kishte krejtësisht pa jetë dhe fytyra i ishte ngrysur.

Po ashtu ai ma drejtoi gishtin mua. Ai tha në shqip: "Ti! Ngrihu dhe eja pas meje!" Për shkak të palltos ai nuk më pa që isha shtatzënë. Më parë ai i kishte thënë edhe Xheva ROMËS që të shkonte pas tij jashtë. Kur ajo u kthye, rrobat i kishte të çrregulluara kështu që unë besoj se bënë të njëjtën gjë me të ashtu si edhe me vajzat. Ai më nxori jashtë në oborr, duke ecur para meje. Unë e lashë djalin tim [REDACTED] në bodrum. Ai filloi të bërtiste e të qante kur u largova sepse është shumë i lidhur me mua.

Ata më nxorën në oborr dhe më çuan në një qoshe me tulla. I pashe dy personat e tjerë me shenjën e tigrin në krahë. Nuk do t'i harroj kurrë fytyrat e tyre.

Burri trupmadh që më kishte sjellë atje, me lëkurë të bardhë dhe flokë në ngjyrë të çelët më urdhëroi: "Zhvishu!" Ai ngriti automatikun drejt fytit tim dhe vazhdoi: "Po nuk u zhveshe dhe po nxore zë, do të vras" Dukej sikur po nxitohej. Në ato çaste u ndjeva

[REDACTED]

shumë keq sepse unë isha nëntë muajsh shtatzanë dhe për shkak të asaj që kisha hequr ditët e fundit. I ula të mbathurat deri te gjunjët dhe rrobat e sipërme deri te gjinjët. Ai i uli pantallonat deri te gjunjët. Ai më preku gjinjët dhe vaginën me duar. Mendoj se ai donte të më përdhunonte megjithëse shtatzania ime ishte e dukshme. Kur më preku unë humba ndjenjat.

Kur erdha në vete, e kuptova se nuk kishte kryer marrëdhënie seksuale me mua. Këtë e them sepse unë e njoh trupin tim shumë mirë. Ai qeshte dhe unë isha mbuluar me rrobat e mia. Ai më kishte drejtuar armën. Ai më tha: “Ngrihu, vishu dhe shko! Ngrihu dhe luaji këmbët!” Unë u ngrita dhe eca para tij dhe shkova te dhoma ku ishin gratë. Mezi ecja sepse ndihesha përnjimend shumë e dobët dhe e rraskapitur. Sapo do të hyja ai më tha: “Ulu dhe pusho!” Unë dëgjova djalin tim duke qarë nga bodrumi.

Një tjetër që dukej si jevg shkoi në bodrum dhe e kapi djalin tim prej rrobash dhe e vendosi në prehrin tim. Ai ma la djalin në prehër për pesë minuta dhe pas kësaj e çoi djalin përsëri në dhomë. Pastaj ai tha: “Ngrihu dhe ec pas meje!” Ai më pyeti: “ku e ke burrin?” Iu përgjigja: “Është në Itali”. Ai shtoi “Dmth të ka marrë malli për burrin” Unë nuk thashë asnjë fjalë. Ai më tha: “Mirë atëherë, punën e tij do ta bëj unë.” Më urdhëroi të zhvishesha. Unë u zhvesha. Gjithë kohën ai foli shqip me mua me theksin jevg. Ai i uli pantallonat dhe të mbathura e tij deri në gjunj. Ai më preku barkun, gjinjët. Ai donte të më prekte kudo; U përpoqa të mbroheshja megjithëse nuk kisha shumë fuqi. Ai e pa që unë nuk kisha dëshirë të bëja seks me atë, kështu që ai nxori thikën e tij të madhe dhe tha “Unë do të të therr! Do ta copëtoj foshnjën tënde!”

Në një çast ai tha: “Shko!” Mu duk sikur nuk kishte kohë sikur ishte me ngut.

U vesha përsëri dhe shkova në bodrum ku ishin gratë dhe fëmijët. Ata erdhën përsëri dhe morën të pesë vajzat, emrat e të cilave i kam përmendur më sipër. Ata morën edhe tri gra më të mëdha në moshë, duke bërë me shenjë nga ato dhe duke thënë: “Ti! Ti! Dhe ti!” Ai u tha vajzave në shqip: Bania hallallin”. Kjo thuhet nga një person përpara se të vdesë; është si lamtumirë nga njerëzit e dashur.

1. Tahire SHALAKU, 62 vjeç, [REDACTED]

2. Fahrie ADEMI, 45 vjeç.

[REDACTED]

3. Miradie DIBRANI, 42 vjeç, e cila ishte nëna e tri motrave DIBRANI

Ata i vranë gratë më të moshuara menjëherë. Ne dëgjuam tri të shtëna nga jashtë. Ky ishte përfundimi logjik që ne nxorëm.

Unë nuk i pashë më këta tre burra me shenjën e tigrin mbi mëngë. Ata e mbvullën derën me tel metalik. Ne e pamë sepse dera prej druri kishte shumë vrima.

Pastaj për rreth gjysmë ore ne ndenjëm në bodrum. Ishim kaq të heshtura sepse nuk e dinim çka do të ndodhte me ato pesë vajza që i kishin marrë, apo çka do të ndodhte me ne. Te dera ruante një polic me uniformë kamuflimi, të kaltër të mbyllët me automatik dhe revolver, me një shirit të kaltër në krah, me flokë të zinj, sy të zinj, fytyrë të zeshkët, 1,75-1,80 i gjatë, me peshë normale, 50 vjeç. Ai hapi derën, i dha djalit tim që ishte më i vogli i të gjithë fëmijëve në dhomë, një shishe qumësht dhe një copë të vogël torte dhe tha në shqip: “Ikni shpejt nga ky vend!” E dija që ishte uniformë policie sepse kur shkova në Skënderaj për të lindur foshnjën kishte shumë prej tyre rreth e rrotull dhe mjeku më tha kush ishin.

Që atje ne u kthyem në Kozhicë në shtëpinë ku ishim mbajtur për tri ditë. Në oborr pamë ata tre burra që na kishin përcjellë deri në Qirez (ata kishin një shirit të kuq në uniformë) dhe ushtarë të tjerë, Ata po bisedonin duke qëndruar në këmbë. Ata na thanë të shkonim brenda dhe të pushonim për pak kohë dhe pastaj thanë: “të shkojmë të kërkojmë për vajzat!” Unë thashë: “Unë nuk mund të eci më” prandaj unë doja të dërgoja vetëm nënën time atje. Ushtari tha: “Nuk do të qëndrosh këtu! Ju do të shkoni bashkë kudo!” Ne takuam atë grupin e fshatarëve nga Klina dhe Prekazi. Ata na pyetën çfarë kishte ndodhur dhe ne iu treguam. Ndërkohë kishte ushtarë serbë. Të gjithë ata që ishin nga Kozhica u kthyen në Qirez.

Ne arritëm në Qirez kur ishte errur dhe na futën në stallën e një shtëpie që ishte afërsisht 300 metra larg nga shtëpia që na kishin mbajtur të kyçura. Shtëpia ishte djegur dhe unë nuk e di e kujt ishte. Ata, tre ushtarët na lanë të qetë, duke na thënë “Asgjë nuk do t’ju ndodhë! Mos u frikësoini!” Ata na sollën bukë, qirinj dhe një djep për djalin tim dhe thanë: “Nesër do të gjejmë vajzat dhe gratë.” Ata na thanë të mos dilnim sepse do të ishim në rrezik për shkak të paramilitarëve. Ata po tregonin se po përpiqeshin të na mbronin. Ne ndenjëm në atë shtëpi dhjetë ditë pa roje. Të tre ushtarët u kthyen në



Kozhice, por në shtëpinë ngjitur ishin ushtarë të Ushtrisë jugosllave të cilët na thanë: “Çfarëdo që t’ju nevojitet, na thërrisni”. Pas shtatë ditësh atje erdhi Mirdita dhe ajo ndenji me ne tri ditë. Gjatë këtyre shtatë ditëve ata erdhën shumë shpesh, ata na provokonin, kërkonin para, njëri prej tyre ma drejtoi armën në kokë. Nuk mund të them numrin e ushtarëve të ushtrisë Jugosllave atje por mund të them që ishin shumë. Pasi Mirdita erdhi atje, ushtarët e Ushtrisë Jugosllave nuk erdhën më për të na kontrolluar. Për dhjetë ditë ne poqëm bukë në furnellë me miellin që gjetëm në stallë. Jashtë oborrit ishte një pus dhe ushtarët e ushtrisë Jugosllave na lejonin herë pas here të merrnim ujë me shishe plastike. Dy ose tri herë në ditë vinte një person që Mirdita më tha se ishte komandanti. Ai solli vetëm për Mirditën ushqime (supë, bukë, mish) kafë dhe cigare, Ai më pyeti: “Çfarë ndodhi? Çfarë ju bënë? Kush e bëri këtë?” pastaj ai tha: “më vjen keq për çfarë të ka ndodhur sepse ti je shtatzanë.” Unë nuk e di gradën e tij. Ai kishte të njëjtën uniformë kamuflimi të gjelbër me të verdhë si ushtarët, me shirit të kuq në krahë; ndryshimi i vetëm ishte se ai kishte një kapelë të gjelbër njëngjyrëshe me majë.

Herë pas here komandanti serb vinte atje dhe më pyeste çfarë kishte ndodhur. Ata thoshin: “Na duhet ky informacion sepse ne po i kërkojmë këta njerëz, ne do t’i gjejmë këto vajza.”

Mirdita ishte ajo që më dërgoi në spital në Skënderaj për të lindur foshnjën, dhjetë ditë para se të lindej djali im, [REDACTED]. Përpos Mirditës që më shoqëroi në spital, të gjitha gratë dhe fëmijët që mbaheshin në atë stallë, mbetën atje. Komandanti dhe një ushtar i Ushtrisë jugosllave na çuan mua dhe Mirditën në spitalin në Skënderaj. Unë e pashë kur ajo po fliste me doctor Bajram MËZLIUN. Pasi linda foshnjën, doktori më mori në shtëpinë e tij dhe më tha se ai e njihte babanë e Mirditës, dhe pas luftës doktori me tregoi se ajo kishte thënë se atij i ishte treguar fakti që motra ime dhe vjehrra ime ishin vrarë.

Unë mendoj se Mirdita na spiunonte në Qirez sepse fliste dhe hante me serbët. Burri im tha: “Unë e di, ne e dimë që ajo është spiune.” Edhe tani ata që kishin luftuar me UÇK-në e kërkojnë ende atë vajzë, por nuk mund t’a gjejnë, me gjasa ajo u largua për në Serbi.

[REDACTED]

Unë mendoj se pa dyshim që ajo duhet të ketë bashkëpunuar me ta. Ajo qëndroi me serbët gjithë natën kur ne ishim të kyçura; ajo pinte cigare dhe bisedonte me ta.

Për vdekjen e motrës sime mësova një muaj pas luftës. Myzafere DOBRA, 34 vjeç, gruaja e Ramadan DOBRËS, kryetarit të komunës së Skënderajt më tregoi se dikush i kishte thënë burrit të saj që motra ime mund të ishte në një pus. Ai person dukej se kishte parë çdo gjë me dylbi.

Unë e takova burrin tim dy muaj pasi ishte nënshkruar marrëveshja e paqes. Burri im kishte luftuar me UÇK-në për gjashtë muaj në Çiçavicë. Ai më tha se e kishte parë Mirditën në Çiçavicë tri javë para asaj që ndodhi në Qirez dhe ajo ishte veshur me uniformën e UÇK-së. Burri im shtoi se ajo u largua nga UÇK-ja dhe u bashkua me ushtrinë serbe, dmth ajo bashkëpunonte me ushtrinë jugosllave.

Tre muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes së paqes motra ime u gjet brenda një pusi. Nuk e di datën e saktë. Vëllai, babai im dhe vëllai im [REDACTED] më thanë se KFOR-i e kishte gjetur kufomën në një pus.

Ata nuk na lejuan ta shikonim kufomën. Ata thanë se viktimat ishin hedhur në pus të gjalla.

Nga gruaja Fahrije ADEMI dhe nga motra ime, të cilat i hodhën në pus, disa nga këpucët e tyre u gjetën të shpërndara në pus, në sipërfaqe. Atje u gjet edhe një këpucë që ishte e vjehrrës sime. Disa nga rrobat e vjehrrës sime u gjetën jashtë pusit (pallto e gjatë në ngjyrë hiri, xhemper ngjyrë krem pa mëngë). Rrobat e saj ishin lidhur me një fije të trashë. Babai im më tha se ai i kishte gjetur ato kështu mbi tokë, pranë pusit.

Unë nuk isha atje kur kufomat u nxorën nga pusi. Burri im dhe babai im ishin atje. Unë shkova vetëm kur ato u varrosën.

Të tetë kufomat u varrosën fillimisht në Qirez. Pas dy tre muajsh, ato u varrosën në Likoshan në "Varrezat e Dëshmorëve"

Motra ime nuk kishte letërnjoftim kur ne u larguam.

[REDACTED]

Babait dhe nënës sime nuk ua treguan kufomën e motrës sime, vetëm rrobat; pantallona të kuqe me vija, kadife, bluzë të zezë leshi me lule, -orape të bardha leshi të thurura nga nëna ime, çorape të pambukta të bardha, çizme me lëkurë të zezë me taka të trasha dhe me lidhësa; dhe bluzë pambuku.

Kjo është ajo që më treguan nëna dhe babai im për çfarë ju ishte treguar për identifikim. Unë e mbaj mend se këto ishin pikërisht rrobat që kishte veshur motra ime kur unë e pashë për herë të fundit. Ajo kishte edhe një orë dore të zezë, që nuk ishte gjetur ose nuk ishte treguar për identifikim.

FUNDI I DEKLARATËS SIME



VËRTETIM I DËSHMITARIT

Kjo deklaratë prej dhjetë faqesh më është lexuar në gjuhën shqipe dhe është e vërtetë me sa di dhe me sa më kujtohet. E kam dhënë këtë deklaratë me vullnet të lirë dhe jam e vetëdijshme se mund të përdoret në procedurat ligjore para Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare të kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej 1991 dhe se mund të thirrem të dëshmoj publikisht para Tribunalit

Nënshkruar/nënshkrim/



VËRTETIM I PËRKTHYESIT

Unë, Bora SHPUZA përkthyesë, vërtetoj se:

1. Jam e kualifikuar dhe e miratuar nga Sekretaria e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej 1991 për të përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe nga gjuha angleze në gjuhën shqipe.
2. Jam informuar nga K24 se ajo e flet dhe e kupton gjuhën shqipe.
3. Kam përkthyer gojarisht deklaratën e mësipërme nga gjuha angleze në gjuhën shqipe në praninë e K24 e cila duket se e ka dëgjuar dhe e ka kuptuar përkthimin tim të kësaj deklaratë.
4. K24 ka vërtetuar se faktet dhe çështjet e paraqitura në këtë deklaratë të përkthyer nga unë, janë të vërteta me sa di dhe me sa i kujtohet dhe rrjedhimisht ka nënshkruar në vendet përkatëse.

Nënshkruar:/nënshkrim/
(Përkthyesja)
Data: 22 nëntor 1999

SHTOJCË e deklaratës së [REDAKTUAR], datëlindja: [REDAKTUAR]

Kjo deklaratë shtesë u bë të hënën më 15 korrik 2002 në Zyrat e Prokurores së TPNJ-së në Hagë, me hetuesen Annete Murtagh, përkthyesen Ardiana Sadikoviq, në praninë e dëshmitares [REDAKTUAR].

Deklarata ime e datave 17-20, 22 nëntor 1999 dhënë hetueses Dana MATEI më është lexuar në gjuhën shqipe dhe e kuptoj. Dëshiroj të bëj këto ndryshime në deklaratë.

Në faqen e dytë me numrat 03054324 në paragrafin e tretë thuhet se unë kreqa katër vite të shkollës fillore, kjo është e pasaktë unë përfundova tetë vite të shkollës fillore.

Në faqen e tretë me numrat 03054325 emri i fundit në listë të 16 është i pasaktë dhe duhet të jetë një emër mashkulli Lumni HALIMI.

Në të njëjtën faqe në rreshtin vijues thuhet se im shoq luftoi me UÇK-në në malin e Çiçavicës, me këtë kam dashur të them se ai shkoi si vullnetar në UÇK, u regjistrua, por nuk kishte as armë dhe as uniformë. Në faqen 11 me numrat 03054333 në paragrafin e tretë unë kam deklaruar se im shoq luftoi në male me UÇK-në për gjashtë muaj. Sërish kam dashur të them se ai ishte me UÇK-në, por nuk kishte as armë dhe as uniformë dhe as nuk mori pjesë në luftime.

Hetuesja Murtagh më ka treguar edhe 9 fotografi sot, me numra në këndin e sipërm të djathtë të fotografisë. Njoh secilën prej këtyre fotografive dhe do t'i përshkruaj një nga një si më poshtë:

Fotografia e parë me numrat K0214638 është fotografi ajrore e fshatit Qirez, në të cilën njoh ahurin ku u mbajta dhe gjithashtu njoh xhaminë e shkatërruar dhe disa prej rrugëve që hyjnë në Qirez.

Edhe fotografia e dytë me numrat K0214639 është e fshatit Qirez dhe e njoh. Shoh ahurin ku u mbajta dhe xhaminë e shkatërruar dhe vendndodhjen e puseve ku u gjetën kufomat.

[REDAKTUAR]

Në fotografinë e tretë me numrat K0214640 është ahuri ku u mbajta dhe unë e njoh prej derës dhe gurëve jashtë në të djathtë të derës.

Në fotografinë e katërt me numrat K0214641 është ana tjetër e ahurit dhe unë e njoh edhe këtë.

Në fotografinë e pestë me numrat K0214642 është pjesa e brendshme e ahurit ku u mbajta, megjithëse në fotografi është ndryshe nga koha kur u mbajta atje.

Edhe në fotografinë e gjashtë me numrat K0214643 është pjesa e brendshme e ahurit por nga ana tjetër, njoh derën dhe stufën në të majtë të derës.

Në fotografinë e shtatë me numrat K0214644 është pjesa e pasme e ahurit, njoh ndërtesën e shkatërruar në të djathtë, këtu më sollën dhe më sulmuan. Gjithashtu njoh vendndodhjen e pusit dhe e shoh në fotografi.

Në fotografinë e tetë me numrat K0214645 mendoj se është vendndodhja e pusit të dytë, jam në gjendje ta shoh në fotografi, njoh njëren nga shtëpitë si ndërtesa ku u mbajtëm kur na sollën fillimisht në Qirez para se të na çonin në ahur.

Nuk e njoh fotografinë e nëntë me numrat K0214646.

Kjo deklaratë më është lexuar në gjuhën shqipe dhe është e vërtetë me sa di dhe besoj.

Nënshkruar: /nënshkrim/

Data: [REDACTED]

Të pranishëm: /dy nënshkrime/